

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME
SHOQERIA ANONIME
“UJESJELLES KANALIZIME ERSEKE”

VENDIM Nr. 1:

Date 02/10/2012

Sot me daten 02/10/2012, ne seline **“UJESJELLES KANALIZIME ERSEKE” SH.A**, person juridik, me seli ne qytetin e Ersekes, nenprefektura Kolonje, paisur me NUIS K275170090, u mblodh asambleja e pergjithshme e shoqerise e cila duke shqyrtuar materialet e paraqitura nga keshilli mbikqyres dhe administrator i shoqerise , bazuar ne nenin 230 te ligjit Nr.9901 date 14/04/2008 “Per Tregtaret dhe ShoqeriteTregtare,”

VENDOSI:

1. Miratimin e statutit te ri te shoqerise te riformeluar sipas kerkesave te ligjit Nr.9901 date 14/04/2008 “Per Tregtaret dhe ShoqeriteTregtare,”
2. Miratimin e objektit te veprimtarise sipas nenit Nr.2, te statutit te ndryshuar.
3. Miratimin e adreses se selise te shoqerise: **Blloku Nr. 5-se Erseke.**
4. Depozitimin e vendimeve te asamblese te pergjithshme (keshillit te bashkise) dhe te vendimeve te Keshillit Mbikqyres ne QKRegjistrimit , kjo edhe per vendimet per te cilat ka kaluar afati per depozitim.

Perfaqesuesi i Asamblese te Pergjithshme

Kryetari i Keshillit te Bashkise

Anesti JORGJI



AKT -THEMELIMI
I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date 15.05 2001 ne baze te Ligjit Nr.8237, date 1.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr.1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr.8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr.1631, date 1.11.1996 dhe Ligjin Nr.8158, date 7.11.1996, Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit

VENDOSI:

1. Te krijoje shoqerine anonime" Ujesjellesi Kanalizime" Kolonje.
2. Objekti I shoqerise eshte:
Furnizimin me uje te pishem qytetin e Ersekës , institucionet dhe sektorin privat, miremban rrjetin e kanalizimeve te ujrave te zeza.
3. Shoqeria do te kete seline e saj ne Erseke dhe ajo mund te çele dege, filiale, agjenci dhe perfaqesi ne te gjitha teritorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratimin e organeve kompetente edhe jashte shtetit.
4. Kapitali themeltar eshte 61.500.000 leke ndare ne 61.500 aksione me vlere nominale 1000 leke.
5. Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.
6. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga :
Z. Nuzet Xheneti
Z .Ilir Cingo
Z. Petraq Kristafillaku
7. Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.
8. Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themeluese.



STATUTI

SHOQERISE ANONIME

"SH.A UJESJELLES KANALIZIME ERSEKE"

NENI 1

Emertimi dhe Selia

Shoqëria aksionere është krijuar nga transferimi i ndërmarrjes shtetërore Ujesjelles Kanalizime Kolonje, me vendim Nr. 26300, datë 09/07/2001, të Gjykatës Tirane.

Shoqëria e krijuar në këtë mënyrë emërohet: **Sh.A.Ujesjelles-Kanalizime**.

Sot me datë 20/09/2012, bazuar në nenin 230 të ligjit Nr.9901, datë 14/04/2008, "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", riformulohet ky statut në bazë të të cilit do të zhvillohet veprimtaria e shoqërisë tani e vazhdim.

Selia e Shoqërisë është në adresë: **Bloku Nr. 5 Erseke**

NENI 2

Objekti i Shoqërisë

Furnizim me ujë të pijshëm të qytetit të Ersekës, institucionet dhe sektorin privat, mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza.

Shoqëria brenda çaqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi do të kryejë çdo operacion tregëtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose terhorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqërive të reja, si dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera jashtë vendit.

NENI 3

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë 61 500 000 leke . Numeri i aksioneve është 61 500 000. Vlera nominale e aksionit është 1000(njëmije) leke .

Kapitali themeltar i shoqërisë zoterohet 100% nga Bashkia Erseke . Në kapitalin themeltar është përfshirë dhe trualli me vlerë 1 067 680 leke.

NENI 4

Transferimi i aksioneve

Transferimi i aksioneve në rastin e privatizimeve apo tjetërsimi i tyre mund të kryhet me vendim të Asamblesë të përgjithshme (Keshillit të bashkës Erseke) si organ perfaqësues dhe vendimëtar i aksionerit të vetëm, bashkia Erseke e drejtë që e ka fituar me V.K.M. Nr. 83, datë 12.02.2004.

NENI 5

Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- 1) Asambleja e përgjithshme.
- 2) Keshilli Mbikqyres
- 3) Administratori/Administratoret.

NENI 6

Asambleja e Përgjithshme

Keshilli i bashkës Erseke është organi perfaqësues dhe vendimëtar që ushtron kompetencat dhe funksionet e asamblese të përgjithshme të kesaj shoqërie.

1. Asambleja e përgjithshme mer vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

a). Përcaktimin e politikave tregëtare.

b). Ndryshimet në statut.

c). Emerimin dhe shkarkimin e anëtarëve të keshillit mbikqyres të shoqërisë.

d). Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të eksperteve kontabel të autorizuar.

e). Miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në paragrafin "c" e "d" të këtij neni.

f). Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar.

g). Perfaqësimin e shoqërisë në gjykate ndaj organeve të administrimit.

h). Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të saj.

i). Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve mbi ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë.

n). Si dhe çështjet e tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statute.

2. Asambleja e përgjithshme mer vendime pas shqyrtimit të dokumentave perkates, se bashku me raportin e keshillit mbikqyres dhe raportin e ekspertit/eksperteve kontabel të miratuar.

3. Te gjitha vendimet e mara nga asambleja e përgjithshme regjistrohen në një regjister të vendimeve , të dhenat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

NENI 7

Thirrja e Asamblese se Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët dhe anëtarët e keshillit mbikqyres.

Rastet e thirrjes së Asamblese se Përgjithshme janë të parashikuara sipas nenit 136 ligjit 9901, datë 14/04/2008, "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Asambleja e përgjithshme thirret nepërmjet një njoftimi me shkresë ose nepërmjet postes elektronike.

Neni 8.

Mbledhjet, kuorumi, dhe maria e vendimeve të Asamblese se Përgjithshme.

1. Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se janë pjesëmarrës me shumicë të paktën 30% e aksionerëve, anëtarëve të asamblese. Kur asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë 50+1% e anëtarëve të asamblese. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës të kuorumit , të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri por jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

2. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë të kualifikuar, asambleja e përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të aksionerëve, që marrin pjesë në votim, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 144 të ligjit 9901, datë 14/04/2008, "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", në lidhje me ndryshimin e statutit; zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar; shpërndarjen e fitimeve ; riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligjin ligjit 9901, datë 14/04/2008, "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", apo në statut, asambleja mer vendime për çështjet e tjera, të renditura në nenin 6 të këtij statuti, ose në nenin 135 të ligjit 9901, datë 14/04/2008, "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me shumicë të votave të anëtarëve të asamblese që marrin pjesë.

4. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjin 9901, datë 14/04/2008, "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", vlefshmeria e vendimeve, që përcaktojnë detyrimet e bashkës mbikqyres apo vendimet, që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj, në statut apo vendime të tjera kushtëzohet nga miratimi i aksionerit perkates.

NENI 9

Keshilli Mbikqyres

1. Anëtarët e keshillit mbikqyres zgjidhen për një afat jo më shumë se 3 vjet, me të drejtë rëzgjedhjeje.

2. Keshilli Mbikqyres i shoqërisë ndryshon nga 3 (tre) anëtarë. Anëtarët e keshillit mbikqyres janë individë të pavarur dhe të ndryshëm nga administratori/administratoret e shoqërisë.

3. Anëtarët e keshillit mbikqyres zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kërkuar sipas pikës 3 të nenit 8 të këtij statuti dhe pikës 2 të nenit 145 të ligjit 9901, datë 14/04/2008, "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", duke zbatuar afatin e emerimit të përcaktuar në statut i cili nuk mund të jetë më i madh se 3 vjet.

Me vendim Nr. 26/2, datë 12/07/2012, Asambleja e përgjithshme e shoqërisë , ka zgjedhur si anëtarë të keshillit mbikqyres shtetasit:

- | | |
|------------|-----------|
| 1. Qemal | Kapllani. |
| 2. Mine | Keri. |
| 3. Belinda | Dymishi. |

NENI 10

Te Drejtat dhe Përgjegjesite e Keshillit Mbikqyres

Keshilli mbikqyres ka të drejtat dhe përgjegjesite e mëposhtme:

a). Të kontrollojë e të mbikqyrë zbatimin e politikave tregëtare të shoqërisë nga administratori/administratoret e shoqërisë.

b). Të pergatisë, me kërkesë të asamblese të përgjithshme, marrjen e masave që janë në kompetencë të kesaj të fundit, të rekomandojë asaj vendime të nevojshme për tu marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblese.

c). Të therasë mbledhjen e asamblese se përgjithshme, sa here vlerësohet e nevojshme për interes të shoqërisë.

d). Të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standartet e kontabilitetit.

e). Të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabel, dokumentat dhe aktivet e shoqërisë

f). Të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore , raportet e ecurisë së veprimtarisë si dhe çdo detyrim të raportimit e publikimit, që janë të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryen me saktësi nga administratorët. Këto dokumenta duhet të nënshkruhen nga anëtarët e keshillit mbikqyres për tu paraqitur asamblese se përgjithshme (Keshillit të bashkës).

g). Të emerojë dhe shkarkojë administratorët/administratoret.

Keshillit mbikqyres mund t'i ngarkohen edhe të drejtat e tjera të parashikuara nga ligji ose të vendosura nga asambleja e përgjithshme.

NENI 11

Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres

Keshilli mbikqyres mbledhet të paktën 2 here në vit sipas nevojave të aktivitetit tregëtar të shoqërisë ose sa here që Asambleja e Përgjithshme e vendos me shumicë të thjeshtë votash, për shpeshësinë e këtyre mbledhjeve.

Anëtarët e Keshillit Mbikqyres emerojnë njerin prej tyre si kryetar të këtij keshilli për drejtimin e veprimtarisë së tij.

Çështjet e rendit të dëtes si dhe vendimet e Keshillit Mbikqyres meren me shumicë të thjeshtë votash, ose me votat e dy anëtarëve, referuar numurit prej tre anëtarësh të këtij keshilli, sipas paragrafit të parë të nenit 9-të të këtij statuti

Keshilli Mbikqyres është vete përgjegjës për mbajtjen në libra të posaçëm të procesverbalëve dhe të të gjitha takimeve të keshillit, duke përfshirë edhe emrat e administratorëve të pranishëm në çdo mbledhje, si dhe për regjistrimin e administrimit e vendimeve të veta.

Vendimet e Keshillit Mbikqyres evidentohen në pajtim me ligjin i keshillit mbikqyres, këtu vendime nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e keshillit, pjesëmarrës në mbledhje.

Kopjet e vendimeve vertetohen nga kryetari i keshillit mbikqyres

NENI 12

Largimi i anëtarëve të Keshillit Mbikqyres

Detyra e anëtarit të Keshillit mbikqyres perfundon në rast se:

1. Personi pushon se qeni anëtar i Keshillit Mbikqyres sipas dispozitave të pikës 4-ter, të nenit 167 dhe nenin 157.

2. Personi ndodhet në gjendje paaftesie paguese.

3. Personi vuan ose mund të vuajë nga paaftesia mendore.

4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose

5. Ka munguar për më shumë se 6 muaj rradhazi , pa lejen e anëtarëve të tjere të Keshillit Mbikqyres në mbledhjet e tij dhe Asambleja e Përgjithshme , me propozimin perkates vendos ta shkarkojë nga detyra.

NENI 13

Administratoret

Keshilli Mbikqyres emeron një ose më shumë persona fizike si administrator të shoqërisë. Administratori/Administratoret mund të rëzgjedhen.

Administratori i shoqërisë nuk mund të zgjidhet në kundërshtim me dispozitën e ligjit 9901 datë 14/04/2008 "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", pika 1 dhe 2 e nenit 158.

Keshilli mbikqyres emeron në detyrën e administratorit të shoqërisë **Orest Malushi**, me vendimin Nr. 4-ter, datë 21/08/2012.

NENI 14

Te drejtat dhe detyrat e Administratorit

1. Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen:

a). Të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregëtare të shoqërisë.

b). Të perfaqësojnë shoqërinë tregëtare.

c). Të kujdeset për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të shoqërisë.

ç). Të pergatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilën ja paraqesin keshillit mbikqyres për miratim se bashku me

propozimet për shpërndarje fitimesh apo administrim të humbjeve , për ta paraqitur me pas për miratim nga asambleja e përgjithshme.

d). Të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershem për rrethanat që kërcenojnë ekzistencën e shoqërisë.

dh). Të kryejnë veprimet e detyrueshme të të dhenave të shoqërisë, sipas parashikimeve të regjistrimit të ligjeve të tjera.

e). Të raportojnë para Keshillit Mbikqyres për zbatimin e politikave tregëtare dhe për realizimin e veprimeve me rendesi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë.

ë). Të kryejnë detyrat e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

2. Detyrat që i cakton ligji keshillit mbikqyres, nuk mund të delegohen administratorit.

3. Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4, 5 të nenit 136 të ligjit 9901, datë 14/04/2008, "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administrator duhet të njoftojë menjëherë kryetarin e keshillit mbikqyres.

NENI 15

Shkarkimi i Administratorit

Detyra e Administratorit mbaron në rast se:

1. Personi nuk është me Administrator në rast se nuk është zgjedhur në bazë të dispozitave të ligjit 9901, datë 14/04/2008, "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

2. Personi ndodhet në gjendje paaftesie paguese.

3. Personi vuan ose mund të vuajë nga paaftesia mendore.

4. Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose

5. Ka munguar për më shumë se 6 muaj rradhazi , pa lejen e anëtarëve të Keshillit Mbikqyres, në aktivitetin administrues të shoqërisë dhe keshillit mbikqyres mer vendim për ta shkarkuar.

NENI 16

Kontrolli Financiar i Shoqërisë

Kontrolli i shoqërisë ushrohet nga 2 (dy) eksperte kontabel të autorizuar, të cilet janë emruar me vendimin Nr. 3/8, datë 13/01/2012, të Asamblese të Përgjithshme dhe që kryejnë detyrën e tyre në pajtim me ligjin, ekspertet e emruar janë:

1. Etleva Ashiku (Nallbati)
2. Bashkim Killo

Neni 17

Ushtimi financiar

Ushtimi financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti.

Perjashtimisht ushtimi i pare financiar përfshin kohën nga data e regjistrimit në regjistrin tregëtar deri me 31 Dhjetor .

Neni 18

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shoqëtar

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901, datë 14/04/2008, "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodi Civil dhe çfardo dispozite ligjore specifike e parashikuara nga legjislacioni shoqëtar në këtë fushë.

Neni 19

Prishja dhe likuidimi i shoqërisë

Prishja, shpërndarja e shoqërisë dhe likuidimi i saj behen me vendim të kualifikuar të Asamblese se Përgjithshme, sipas kërkesave të parashikuara në ligjin 9901, datë 14/04/2008 "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 20

Zgjidhja e mosmarrveshjeve

Për të gjitha mosmarrveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tregëve do të jete kompetentë Gjykata Shqiptare.

NENI 21

Dispozita të fundit

Pasuria e shoqërisë mund të sigurohet në ndonjerin nga institutet Sigurimit si brenda dhe jashtë vendit.

Shoqëria do të ketë vullën e saj, formë dhe madhësinë e se ciles janë kompetencë e keshillit mbikqyres.

Ky statut u hartua në datën 20/09/2012, në tre ekzemplare me përmbajtje dhe vlerë të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi u miratua në parim dhe nënën nga Asambleja e Përgjithshme, u nënshkrua dhe u vulos në të gjitha kopjet nga perfaqësuesi ligjor kesaj asambleje.

PERDAQESUESI LIGJOR I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME KRYETARI I KESHILLIT TE BASHKISE

Anesti JORGJI

